

# PYETJE: «NË QOFTË SE JEZUSI ISHTE NJË NJERI AQ I MIRË, ATËHERE PSE U EKZEKUTUA SI NJË KRIMINEL ORDINER?»

**PËRGJIGJE:** Kur mendojmë për kryq-in, ne menjëherë pyesim: «Në qoftë se Jezusi ishte një njeri aq i mirë, atëhere pse vdiq si një kriminel ordiner?»

Një vajzë adoleshente njëherë më pyeti e çuditur: «Në qoftë se Jezusi nuk bëri asgjë të keqe, atëhere pse u kryqëzua Ai? Kjo nuk më duket e drejtë.» Kjo është një pyetje e drejtë apo jo?

E para, kjo është pyetje e drejtë, sepse Jezusi ishte njeri i mirë. Gati të gjithë heronjtë e historisë kanë pasur nga një të metë. Ata me të vërtetë kanë patur virtyte dhe cilësi shumë të mira, por gjithashtu ata kanë pasur gabimet dhe dobësitë e tyre. Por kjo s'është e vërtetë për Jezusin. Asnjë njeri nuk e ka kundërshtuar faktin se Jezusi ishte njeri i mirë. Ndoshta jobesimtarët e konsiderojnë Atë si pak të çuditshëm, ose jeta dhe mësimet e Tij mund t'u duken jopraktike. Por asnjë s'mund të mohojë faktin se Ai ishte *njeri i mirë*.

Gjithashtu pyetja është e drejtë, sepse Jezusi u kryqëzua si një kriminel ordiner. Shumë vetë kryqëzoheshin në ato kohëra. Aleksandri i Madh kryqëzoi një mijë nga armiqtë e tij gjatë fushatës kundër Tiros. Dhe, sipas Josephus (historian i shquar i shek.I A.D.), kur romakët pushtuan Jeruzalemin në vitin 70 A.D., ata kryqëzuan tridhjetë mijë burra hebrenj mbi muret e qytetit.

Nga një pikëvështrim tjetër, vdekja e Jezusit nuk ishte si ajo e një krimineli «ordiner». Në Perandorinë Romake, kryqëzimi edhe pse një formë e zakonshme ndëshkimi, përdorej vetëm për skllëvërit, të huajt apo për kriminelët që i përkisnin klasës më të ulët të shoqërisë. Zakonisht qytetarët

romakë nuk kryqëzoheshin. Pra, kryqëzimi nuk ishte për një kriminel «ordiner», por ishte për një kriminel «të pazakontë». Kryqëzimi ishte një formë ndëshkimi që, përveç të tjerave, përdorej për të hedhur baltë mbi atë që do të kryqëzohej. Kryqëzimi ishte për këta njerëz një vdekje e pazakontë, e turpshme, plot dhembje dhe e përzgatur.

Mijra të tjerë vdiqën në kryq ashtu si vdiq Jezusi. Po, pse duhej që Ai, që ishte njeri i mirë, të provonte llojin e vdekjes që përdorej si ndëshkim për llumin e njerëzimit?

Sinqerisht, në qoftë se vdekja e Jezusit ishte e njëjtë me atë të njerëzve të tjerë të kryqëzuar, atëherë ajo vdekje nuk do të kishte ndonjë vlerë për ne. Shpresa e kristianizmit qëndron në faktin se vdekja e Krishtit ishte në shumë mënyra *e veçantë*. Në pamje të jashtme, vdekja e Tij ngjasonte me atë të shumë njerëzve të tjerë, por në realitet ajo ishte shumë e ndryshme.

## AJO ISHTE VDEKJA E NJË NJERIU TË PAFAJSHËM

Vdekja e Jezusit ishte e ndryshme, sepse ajo ishte vdekja e një njeriu të pafajshëm.

Ungjijtë e thonë qartë se Jezusi nuk kishte bërë ndonjë gjë që të meritonte ndëshkimin. Madje *vetë armiqtë e Jezusit nuk mund të gjenin ndonjë dëshmi kundër Tij* (Mateu 26:59, 60). Jezusi ishte kaq i pafajshëm sa madje edhe njerëzit gënjeshtarë nuk mund të gjenin ndonjë gjë për ta fajësuar Atë! *Për zyrtarët romakë, Pilatin dhe Herodin, Jezusi ishte i pafajshëm* (Luka 23:14, 15). Të vetmit njerëz që mund të gjykonin objektivisht për Jezusin ishin

Pilati dhe Herodi dhe ata të dy thanë se Ai nuk ishte fajtor! *Gruaja e Pilatit tha se Jezusi ishte i pafajshëm!* Ajo i çoi fjalë Pilatit: «. . . Mos u përziej aspak me çështjen e atij të drejti . . .» (Mateu 27:19). *Kur Jezusi vdiq, vetë komandanti romak, të cilit i ishte ngarkuar detyra e ekzekutimit të Jezusit, deklaroi se Jezusi ishte i pafajshëm.* Pasi pa vdekjen e Jezusit, ai «përlëvdoi Perëndinë duke thënë: “Me të vërtetë ky njeri ishte i drejtë”» (Luka 23:47). Në qoftë se ky ushtar i pamëshirshëm, i cili ishte i pranishëm gjatë vdekjes së Jezusit, u bind për pafajësinë e Tij, atëherë ne nuk kemi ndonjë arsye për të mos besuar në pafajësinë e tij! *Një nga dy hajdutët e kryqëzuar në një kryq përkrah kryqit të Jezusit pranoi se Ai ishte i pafajshëm:* «. . . ky nuk ka bërë asnjë të keq» (Luka 23:41). Jezusi ishte tërësisht i pafajshëm.

### **AJO ISHTE VDEKJA E NJË NJERIU QË ASNJEHERË GJATË JETES TË TIJ NUK KISHTE MËKATUAR**

Vdekja e Jezusit ishte e ndryshme, sepse ajo ishte vdekja e një njeriu pa faje dhe pa mëkate. Jezusi s’ ishte fajtor për krimin për të cilin u akuzua. Ky rast është i pazakontë, por jo i vetëm. Ato që kemi thënë deri tani për Jezusin mund t’i themi edhe për njerëz të tjerë: Ai vdiq i pafajshëm.

Por ne nuk mund të themi faktin e mëposhtëm për ndonjë njeri tjetër. Vetëm Jezusi jetoi dhe vdiq pa mëkatuar. Jo vetëm që nuk ishte fajtor për ndonjë krim kur u kryqëzua, por Ai gjithashtu nuk ishte fajtor as edhe për ndonjë mëkat gjatë gjithë jetës së Tij!

Shkrimtari i Hebrenjve thotë se Jezusi «u tundua në të gjitha ashtu si ne, por pa mëkatuar» (Hebrenjve 4:15). Në shkretëtirë, Jezusi nuk iu nënshtua tundimeve të djallit. Por ky nuk ishte fundi i tundimeve të tij. Ai «u tundua në të gjitha . . . si ne», por prapë s’ mëkatoi.

Jezusi pyeti: «Cili nga ju më bind për mëkat?» (Gjoni 8:46). Anjëri nuk mundi atëherë dhe asnjë nuk ka qenë në gjendje ta provojë këtë prej asaj kohe. Vdekja e Jezusit ishte e veçantë, sepse Ai ishte pa mëkate.

### **PËR VDEKJEN E JZUSIT FOLËN EDHE PROFETËT, SHUMË SHEKUJ PËRPARA SE AI TE VDISTE**

Vdekja e Jezusit ishte e ndryshme, sepse ajo

ishite profetizuar. Ai vetë parashikoi dhe foli për vdekjen e Tij. Pasi Pjetri kishte pranuar Jezusin si Birin e Perëndisë dhe Jezusi kishte folur për fillimin e kishës, Jezusi filloi «t’u sqarojë dishepujve të vet se i duhej të shkonte në Jeruzalem, . . . do të vritej dhe do të ringjallej të tretën ditë» (Mateu 16:21). Në atë kohë, askush nuk po e kërkonte Jezusin për ta vrrarë. Një nga momentet më të rëndësishme të jetës së Jezusit, hyrja e Tij triumfuese në Jeruzalem, po afrohej. Megjithëse ky ishte një moment kur popullariteti i Jezusit arriti një nga kulmet e tij, prapë Ai e dinte se do të vdiste dhe ua tregoi këtë fakt dishepujve të Tij.

Në fakt, vdekja e Tij u parashikua kohë më parë. Profetët e Testamentit të Vjetër profetizuan për vdekjen e Tij. Gjoni, për shembull, theksoi se Shkrimet e Testamentit të Vjetër u plotësuan kur ushtarët ndanë rrobat e Jezusit (Gjoni 19:28), kur ata nuk i thyen këmbët e Tij (Gjoni 19:36) dhe kur ata e tejshpuan Atë në brinjë (Gjoni 19:37).

Predikuesit e frymëzuar të Testamentit të Ri theksuan se vdekja e Jezusit përbushi thëniet e Shkrimeve të Shenjta. Këta predikues duhet t’i përdornin këto fakte, sepse, kur u flisnin hebrenjve për Jezusin, ata duhet t’i bindnin ata se ky Jezus ishte Mesia i *kryqëzuar*. Hebrenjtë nuk mund ta kuptonin këtë. Ata mendonin se Mesia ishte një mbret i madh, një udhëheqës i shquar luftarak i cili do t’i udhëhiqte ata në luftën çlirimtare kundër pushtuesve romakë. Vdekja e Mesisë në kryq ishte e panjohur për ta, sepse, sipas besimit të tyre, ata që kryqëzoheshin ishin të mallkuar. Si rrjedhim, Pali u tha hebrenjve në Antioki të Pisidisë: «Sepse banorët e Jeruzalemit, . . . duke mos e njohur këtë Jezus, duke e dënuar, kanë përbushur fjalët e profetëve» (Veprave 13:27). Kryqëzimi i Jezusit ishte *përmbushja* e Shkrimeve të Biblës.

Cilat janë Shkrimet që u përbushën me vdekjen e Jezusit? Shikoni vetëm një kapitull nga Testamenti i Vjetër, kapitullin 22 nga libri i Psalmeve. Ky kapitull fillon me fjalët që vetë Jezusi tha në kryq: «Perëndia im, Perëndia im, pse më ke braktisur?» (v. 1). Pastaj flet për Mesinë si «turpi i njerëzve dhe përçmimi i popullit», për njerëzit që e përqeshën Atë, për duart dhe këmbët e tejshpuara të Mesisë, për ndarjen e rrobave të Tij (vargjet 6–8, 16–18). Dhe këtu gjenden edhe fjalët e paharrueshme: «Ndajnë midis tyre rrobat e mia dhe hedhin në short tunikën time» (v. 18).

Çfarë na tregon përmbushja e Shkrimeve të tilla? Përveçse tregon se vdekja e Jezusit ishte parathënë, ajo gjithashtu vërteton se Bibla është frymëzuar në mënyrë hyjnore dhe se Jezusi është Biri i Perëndisë. Asnjë njeri nuk mundet, me anë të zgjuarësisë dhe fuqisë së tij, të parathotë hollësitë e vdekjes së dikujt me saktësinë e pabesueshme të shkrimtarëve të Biblës. *Në mënyrë të veçantë kjo është e pamundur të bëhet qindra vite përpara lindjes së atij njeriu!* Atëherë, si mundën profetët të bënin gjithë ato parashikime? Me anë të fuqisë së Perëndisë! Përmbushja e këtyre profecive vërteton se Jezusi me të vërtetë ishte Mesia i dërguar nga Perëndia dhe se profetët ishin me të vërtetë të frymëzuar nga Perëndia, kur shkruan për Mesinë.

### VDEKJA E JEZUSIT ISHTE E PLANIFIKUAR

Vdekja e Jezusit ishte e ndryshme, sepse ajo ishte planifikuar shumë kohë më përpara. Jezusi nuk ishte thjesht një njeri i mirë që aksidentalisht ra në duart e romakëve. Vdekja e Tij ishte e paramenduar. Gjithë jetën e Tij Ai jetoi nën hijen e kryqit (vdekjes në kryq). Nga koha që lindi deri sa vdiq, Jezusi eci pa u lëkundur drejt Golgotës.

Pjetri, në ditën e Rrëshajëve, u foli atyre që shkaktuan kryqëzimin e Jezusit, duke thënë për Të: «Ai, pra, sipas këshillit të caktuar dhe të paranojohur të Perëndisë, ju dorëzua juve dhe ju e zutë dhe, me duart e të padrejtëve, e gozhduat në kryq dhe e vratë» (Veprave 2:23). Jezusi u kryqëzua sipas planit të Perëndisë. Perëndia planifikoi jo vetëm vdekjen e Tij, por edhe mënyrën se si do të vdiste.

Kështu, ajo që ndodhi në kryq nuk ishte një ndryshim i planit të Perëndisë nga njerëzit e këqinj. Gjithçka ndodhi sipas parashikimit të Perëndisë. Por kjo nuk i bën më pak fajtorë vrasësit e Jezusit. Çdo njeri në turmën që bërtiti: «Kryqëzoheni!» ishte atje me dëshirën e vet. Çdo njeri, me dëshirën e vet, zgjodhi që të kryqëzojë Jezusin dhe secili që bëri atë zgjedhje ishte fajtor për vdekjen e Tij.

Pse vdiq Jezusi? Ai vdiq, sepse Perëndia e planifikoi vdekjen e Tij. Vdekja e Jezusit ishte pjesë e qëllimit të përgjithshëm dhe e planit të pandryshueshëm të Perëndisë. Kjo e bëri vdekjen e Jezusit të veçantë.

### NGJARJET QË SHOQËRUAN VDEKJEN E JEZUSIT

Vdekja e Jezusit ishte e veçantë për arsye të ngjarjeve që shoqëruan kryqëzimin e Tij. Kapitulli 27 i Mateut përmend katër ndodhi të çuditshme: errësirën e mbinatyrshme që mbuloi gjithë tokën për tre orë (v. 45), grisjen e perdes së tempullit nga lart poshtë (v. 51), tërmetin (v. 51) dhe ringjalljen e trupave të të shenjtëve pas ringjalljes së Jezusit (vargjet 52, 53).

Këto ndodhi tregojnë se diçka e jashtëzakonshme po ndodhte në kryq, diçka e mbinatyrshme. Ato thonë: Kjo është dora e Perëndisë! Perëndia po vepron! Njeriu nuk mund të errësojë diellin, por Perëndia mund dhe e bëri. Perëndia grisi perden nga lart poshtë dhe jo nga poshtë lart, kështu që nuk do të kishte ndonjë dyshim se kush e grisi. Njeriu nuk mund të shkaktojë tërmete, por Perëndia mund dhe Ai i shkaktoi. Njeriu nuk mund të ringjallë të vdekurit, por Perëndia mund dhe Ai i ringjalli. Diçka e veçantë në historinë e njeriut ndodhi në kryq: Biri i Perëndisë vdiq atje. Këto ngjarje të mbinatyrshme dëshmojnë për këtë fakt.

Nuk është e çuditshme, që kur komandanti romak dhe të tjerët me të «panë tërmetin dhe ngjarjet e tjera, u trembën shumë dhe thanë: “Me të vërtetë ky ishte Biri i Perëndisë!”» (Mateu 27:54).

### JEZUSI VDIQ PËR TË TJERËT

Vdekja e Jezusit ishte e veçantë, sepse Ai vdiq për të tjerët. Meqënëse vdekja e Tij ishte parashikuar, planifikuar dhe kryer nga Perëndia, cili ishte roli i saj në realizimin e qëllimit të Tij? Problemi kryesor është ky: Në qoftë se Jezusi ishte i pafajshëm, pse duhej, sipas planit të Perëndisë, të vdiste?

Meqënëse Jezusi nuk vdiq për veten e Tij, sepse Ai s’kishte as fajë dhe as mëkate, atëherë Ai vdiq për të tjerët. Ai *duhej* të vdiste për të tjerët, sepse vetëm kështu njerëzit do të kishin mundësinë e shpëtimit.

Testamenti i Ri e thekson se Jezusi vdiq për të tjerët. Jezusi tha: «Sepse ky është gjaku im, gjaku i besëlidhjes së re, i cili është derdhur për shumë për faljen e mëkateve» (Mateu 26:28). Pali shkroi: «... kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne» (Romakëve 5:8). Ungjilli, sipas Palit, përfshin faktin se «Krishti vdiq për mëkatet tona» (1 Korintasve 15:3). Shkrimtari i Hebrenjve tha se Krishti u bë njeri me qëllim «që me hirin e Perëndisë të provonte

vdekjen për të gjithë njerëzit» (Hebrenjve 2:9).

Kapitulli 53 i Isaias në Testamentin e Vjetër deklaroi të njëjtin lajm të mirë. Vargjet 4–6 thonë:

Megjithatë ai mbante sëmundjet *tona* dhe kishte marrë përsipër dhembjet *tona*; por ne e konsideronim të goditur, të rrahur nga Perëndia dhe të përlulur. Por ai u tejshpua për shkak të shkeljeve *tona*, u shtyp për paudhësitë *tona*; ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të, dhe për shkak të vurratave të tij *ne* jemi shëruar. . . Dhe Zoti bëri që të bjerë mbi të paudhësia e ne të gjithëve.

Jezusi vdiq për të tjerët. Çfarë do të thotë kjo? Jezusi mori mbi veten e Tij mëkatet e të tjerëve. Ai mori mbi veten e Tij fajin dhe ndëshkimin e mëkateve të mia dhe të tua gjithashtu. Pali tha:

. . . sepse Perëndia e ka pajtuar botën me veten në Krishtin, duke mos ua numëruar njerëzve fajet e tyre dhe vuri ndër ne fjalën e pajtimit. . . . Sepse ai bëri të jetë mëkat për ne ai që nuk njihet mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në të (2 Korintasve 5:19, 21).

Krishti zuri vendin e mëkatit tonë kur vdiq në kryq. Ai pagoi ndëshkimin për mëkatet e tua dhe të mia, kur duroi dhembjet e ferrit për ne. Ferri është vendi ku njerëzit ndahen nga Perëndia përgjithmonë (2 Thesalonikasve 1:9). Jezusi gjatë orës së vdekjes së Tij, ishte ndarë nga Ati dhe bërtiti: «Perëndia im, Perëndia im, pse më ke braktisur?» (Mateu 27:46).

Pse e *kishte* braktisur Perëndia Jezusin? Sepse Jezusi ishte kthyer në mëkat për ne! Sepse Ai kishte marrë mbi veten e Tij fajin e gjithë mëkateve *tona*. Perëndia, që është i tëri i shenjtë, nuk mund të lejojë mëkatin në praninë e Tij. Perëndia duhej t'i kthente krahët Jezusit në kryq, sepse atje Krishti ishte kthyer në mëkat për ne. Ai e ndau veten e Tij nga Krishti, në të njëjtën mënyrë që Ai do të ndajë veten e Tij për gjithë përjetësinë nga gjithë mëkatarët e pashpëtuar.

Kur Jezusi vuajti ndëshkimin e plotë për mëkatin, Ai mori mbi vete ndëshkimet e ferrit. Pasi Jezusi kishte paguar çmimin për mëkatet *tona* dhe pasi kishte vuajtur ndëshkimin e plotë që kërkohej për mëkatin, Ai bërtiti: «Ka mbaruar» dhe vdiq.

Pse ishte Jezusi në kryq? Ai ishte në vendin tuaj dhe timin dhe vuajti vuajtjet që duhet t'i kishim vuajtur ne. Ne mund të shpëtohem, sepse Ai vdiq për ne dhe mori mbi veten e Tij fajin e mëkateve *tona*! Ne nuk kemi për të paguar për mëkatet *tona*, sepse Ai pagoi për to. Ne nuk duhet të vemi në ferr,

sepse Ai e vuajti agoninë e ferrit për ne.

Në historinë njerëzore, vdekja e një njeriu shpesh ka ndihmuar shpëtimin fizik të njerëzve të tjerë. Por vetëm Krishti, Perëndia në trup njerëzor, mundi të marrë mbi veten e Tij mëkatet e gjithë njerëzve dhe të paguante ndëshkimin për këto mëkate. Gjithashtu, vdekja e Krishtit ofron mundësinë për shpëtimin shpirtëror të të gjithë njerëzve.

## VDEKJA E JEZUSIT U PASUA NGA RINGJALLJA E TIJ

Vdekja e Jezusit ishte e veçantë, sepse ajo u pasua nga ringjallja e Tij. Në ditën e parë të javës, një engjëll e rrokullisi gurin nga hyrja e varrit dhe u ul mbi të. Engjëlli i tha gruas që erdhi te varri: «Mos kini frikë, sepse unë e di se ju kërkoni Jezusin, që u kryqëzua. Ai nuk është këtu, sepse u ringjall, sikurse kishte thënë» (Mateu 28:5, 6). Jezusi u ngrit nga vdekja dhe si pasojë e kësaj, vdekja e Tij ishte e veçantë.

Jezusi u ngrit nga vdekja për të qenë fitimtar ndaj saj. Në qoftë se Ai do të kishte mbetur i vdekur, atëherë vdekja do të kishte fituar. Por, Jezusi triumfoi mbi vdekjen, sepse Ai u ringjall.

Nga kjo fitore, Ai «u deklarua Biri i Perëndisë në fuqi, sipas Frymës së shenjtërisë nëpërmjet ringjalljes prej së vdekurit. . . » (Romakëve 1:4). Ringjallja është një demonstrim i fuqishëm i hyjnisë së Krishtit. Ajo provoi pretendimin e Tij se Ai është Biri i Perëndisë.

Meqënëse Ai ishte Biri i Perëndisë, sakrifica e Tij në kryq ishte e efektshme. Kjo është sikur Krishti pagoi një shumë të hollash për ju me vdekjen e Tij. Kjo sasi të hollash është në emrin tuaj tani. Sa është vlera e kësaj pagese? Kjo pagesë është bërë për shpëtimin, jetën e përjetshme. Po, kaç shumë ka premtuar t'ju japë. Kjo sasi të hollash është dhuruar nga vetë Krishti. Dhe ringjallja e Krishtit e bën të vlefshme këtë pagesë. Ringjallja është garancia e Perëndisë për këtë. Në këtë mënyrë, ne mund të sigurohemi dy herë për shpëtimin tonë: Mund të sigurohemi se do të shpëtohem, sepse Krishti vdiq për ne dhe mund të sigurohemi se do të shpëtohem, sepse Ai që vdiq (Krishti) u ngrit nga vdekja.

## KONKLUZIONI

Atëherë, pse vdiq Jezusi si një kriminel ordiner? Ndërsa në pamje të parë vdekja e Tij i ngjan vdekjes së mijra njerëzve të tjerë, ajo ishte e veçantë.

Pse vdiq Jezusi në atë mënyrë të veçantë? Lajmi i mirë i ungjillit është se Jezusi vdiq me një qëllim, që ne të mund të shpëtohemi me anë të jetës, vdekjes dhe ringjalljes të Tij.

Lajmi i keq është i lidhur me ungjillin, gjithashtu. Mëkati është i vërtetë dhe ai mëkat do t'ju ndëshkojë. Ata që mëkatojnë dhe refuzojnë shpëtimin e ofruar nga Krishti do të ndëshkohen përjetë. Gjykimi do të vijë një ditë dhe ne të gjithë do të gjykohehi. Pas

gjykimit vjen qielli apo ferri, të cilët do të zgjasin në përjetësi. Nuk ka ndonjë rehati apo ngushëllim në këto fakte veçse në qoftë se ju jeni shpëtuar me anë të vdekjes së Tij.

Natyrisht, mëkati, gjykimi dhe ferri nuk duhet t'ju trembin. Krishti vdiq për të hequr frikën që vjen nga ndëshkimi i mëkatit. Ju mund të çlirohëni nga ndëshkimi i mëkatit në qoftë se shpëtoheni përmes vdekjes së Tij.

Autor: *Coy Roper*  
Marrë nga studimi: *"Pyetje lidhur me besimin te Perëndia"*  
© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara